

PROPOZIME TË TË RINJVE

“Impakti i COVID-19 në arsimin e lartë në Shqipëri”

Në kuadrin e projektit ‘Debati universitar për integrimin: Edicioni 2 - Nga fjala tek veprimi’
me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Ky dokument është përgatitur nga:

Silvana Rusi - Instituti i Studimeve Europiane

Dhimitër Çipi - Universiteti Europian i Tiranës

Marime Gjoka - Universiteti i Tiranës

Iris Beqiri - Universiteti i Tiranës

nën mentormin e Dr. Erida Curraj në kuadër të fushatës “Nga Fjala tek Veprimi”

©SCiDEV

Tiranë, Prill 2021

Përmbajtja

Përmbajtja	3
Hyrje	4
Përcaktimi i problematikës	5
Rekomandime për Politikat	7

Hyrje

SCiDEV, bazuar në përvojën e krijuar dhe në interesin e ngjallur nga universitetet, pedagogët dhe studentët gjatë edicionin të parë “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare” (2019-2020), mbështetur nga Fondacioni për Shoqëria e Hapur për Shqipëri, nisi në Shtator 2020 një edicion të dytë të debatit, por duke pasur parasysh kontekstin e ri ku veprojmë jo vetëm me hapjen e negociatave, por edhe me krizën shumë dimensionale social-ekonomike të shkaktuar nga COVID-19 si edhe me nevojën për një rini të angazhuar dhe të motivuar.

Në kuadër të edicionit të dytë të projektit “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitarë-“Nga fjala tek veprimi”, zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) dhe mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), u realizuar programi i ngritjes së kapaciteteve. Gjatë këtij programi, të rinjtë debatues u trajnuan nga ekspertë të fushës me tematike të ndryshme si: ‘Aktivizmin publik dhe politik’, ‘Përdorimi i mjeteve digjitale për aktivizëm’, ‘Pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse: Arsimit të Lartë’. Në këtë seri trajnimesh studentët u njohën nga afër me disa nga proceset vendimmarrëse dhe përfshirjen e studentëve në strukturat e Arsimit të Lartë si strukturat e sigurimit të cilësisë, qeveria studentore, klubet dhe organizatat studentore, Ligji mbi Arsimin e Lartë, etj.

Në vazhdimësi, SCiDEV pilotoi një program “Nga fjala tek veprimi” për mbështetjen e 8 të rinjve debatues për të vënë në jetë nismat e tyre bazuar tek aftësitë e fituara gjatë programit të zhvillimit të kapaciteteve dhe debatit me fokus sektorin e arsimit të lartë dhe në kontekstin e zgjedhjeve parlamentare të 25 prill 2021. Fokusi i fushatës është ndikimi i pandemisë COVID-19 në arsimin e lartë. Të rinjtë, nën mentorimin e ekspertëve, kanë bërë një analizë të thelluar të situatës, kanë hartuar propozime konkrete dhe më pas i kanë parashtruar idetë e tyre kandidatëve për deputet.

Ky dokument paraqet një përmbledhje të analizës kërkimore dhe parashtron propozimet e të rinjve debatues.

Përcaktimi i problematikës

Arsimi i lartë në Shqipëri është mes sektorëve me historikun e polemikave të shumta përgjatë viteve, me reformime të vazhdueshme, me kërkesa të aktorëve të ndryshëm (studentë, lektorë, Institucione të Arsimit të Lartë/IAL në vijim, ekzekutivi) që duhen ekuilibruar, si dhe balanca të rëndësishme që duhen garantuar mes ndërhyrjes në masë të pranueshme e ligjore të shtetit e autonomisë universitare dhe financimit publik e vetëfinancimit të sektorit, mes të tjerash. Parë në këtë kuadër dhe në një linjë kronologjike të ecurisë së kësaj shtylle në vend të paktën në dekadën e fundit, pandemia e COVID-19 e gjeti arsimin e lartë në Shqipëri të papërgatitur në financa, logjistikë, metodikë mësimdhënieje e ofrim shërbimesh. Në këtë punim kemi marrë në shqyrtim si më poshtë disa prej aspekteve kyçe që lipset të gjejnë zgjidhje afatgjatë, meqenëse janë rrenjët e disa prej problematikave më të mëdha që u evidentuan përgjatë këtij viti të plotë (Mars 2020-Mars 2021) me kalimin e mësimin universitar online, dhe të cilat ende nuk kanë gjetur zgjidhje. Në metodologji kemi kryer kryesisht desk research dhe kontakt me studentë për të bërë një panoranim sa më objektiv të situatës.

Ligji i arsimit të lartë jep një përcaktim të qartë mbi autonominë univeristare ku institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Roli i shtetit në arsimin e lartë ushtrohet nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, dhe në cdo rast garanton autonominë dhe lirinë akademike dhe vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor, në përputhje me përparësitë e zhvillimit dhe interesave strategjikë të vendit. Këto parime thelbësore të përcaktuara nga ligji i sipërcituar në disa raste bien ndesh me disa nene dhe me disa vendime të ndryshme të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në disa drejtime që prekin atë të organizimit të mësimdhënies dhe të menaxhimit të fondeve.

Për më tepër qeveria miratoi akt nenligjor (Nr.397, datë 3.5.2017) për krijimin (por nuk funksionon) e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) e cila shpërndan, planifikon fondin për mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë dhe infrastrukturën akademike. Një agjenci në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka për mision shpërndarjen e fondeve publike për mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë, mbështetjen me bursa studimi për studentët dhe garantimin e skemës së kredive studentore, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Natyrshëm që kjo mbivendosje midis ligjeve dhe akteve nënligjore jo vetëm që sjell dhe shkelin autonominë dhe mos lejimi i IAL-ve ti përdorin fondet sipas nevojave të tyre thelbësore por shkaton dhe abuzime nga ana e strukturave të IAL-ve në shumë raste. Emisione investigative të ndryshme dhe organizata të rëndësishme kanë kryer analiza dhe monitorime të posaçme mbi administrimin e fondeve dhe efikasiteti i përdorimit të tyre.

Organizata “Qëndresa Qytetare” analizoi një seri premtimesh dhe politikash të miratuara gjatë viteve 2013-2020 për arsimin dhe rininë, një pjesë e mirë e së cilave ose kanë dështuar ose janë realizuar pjesërisht. Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e

arsimit të lartë pësuan sa i takon menaxhimit financiar dhe administrimit, Qëndresa Qytetare monitoroi shtatë universitete publike me fokus investimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për periudhën 15 Shkurt deri më 31 Tetor 2019. Ky monitorim shërbeu për të hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit duke u munduar kështu t’i japë përgjigje pyetjes nëse reflektohen nevojat reale të studentëve apo kemi të bëjmë më një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor të universiteteve.

Një nga aspektet më të rëndësishme që meriton vëmendje të shtuar është çështja e diplomave dhe vetë procesit të diplomimit në përgjithësi në Shqipëri. Për pjesën e diplomimit në ligj nuk parashikohet apo nuk përmendet një mundësi për diplomim online ndërkohë që kështu është vepruar dhe për këtë arsye ka kontestime dhe paqartësi nëse ky diplomim vlen si edhe duhen kryer parashikime ligjore në të ardhmen.

Problematikë tjetër jo me pak rëndësi ka qenë për studentët edhe fakti i pagesave që ata kishin bërë për këstet disa mujore të konvikteve. Megjithëse disa nga studentët kanë paguar për disa muaj deklarata nga Drejtoria e Qytetit Studenti thekson se kjo pagesë vlen për muajt në vijim, por mësimi online vazhdoi për muaj të tërë dhe ende po vazhdon dhe studentët janë të shqetësuar për këtë. Nëse kjo pagesë do t’u kthehet ndonjëherë. Vlen për tu theksuar se vendimi erdhi me mjaft vonesë pasi u mor vetëm 4 ditë para nisjes së mësimit edhe pse rastet qenë të vazhdueshme gjatë gjithë tetorit bazuar në të dhënat e Ishp. Ky problem që gjithashtu i trashëguar që në semestrin e kaluar. Ky moskoordinim ka rënduar mbi ekonominë e brishta studentore ku për shkak të situatës kanë humbur jo vetëm këstet e paguara, por edhe punët në kryeqytet me të cilat siguronin të ardhurat.

Për tu përmendur mbetet gjithashtu edhe mospërgatitja e pedagogëve për mënyrat e reja të mësimdhënies. Përpos faktit që pedagogët nuk kanë qenë të përgatitur atyre u ka munguar edhe trajnimi pasi platforma specifike kanë updatime të herëpashershme. Me një traditë të munguar në mësimdhënien online universitetet shqiptare shfaqin handikape edhe në një përditësim tjetër atë të udhëzimit të mësimin në distancë nga vetë universitetet. Në fakt gjatë këqyrjes së statuteve të universiteteve më të mëdhenj në vend shihet se pedagogët kanë si detyrim në pjesën më të madhe të universiteteve të specifikuar se ata duhet të ndjekin zhvillimet e reja të shkencës dhe t’i inkorporojnë ato në procesin mësimor.

Universitetet kanë shfaqur mangësi edhe në procesin e përzgjedhjes së këshillave të rinj studentorë zgjedhje në të cilat mungoi transparenca dhe pjesëmarrja pasi u zhvilluan në një periudhë tejet të papërshtatshme pa marrë parasysh se shumica e studentëve nuk arritën të votonin për shkak të pandemisë.

Aspekti me më shumë ndikim sot për sot është konsiderimi i problemeve me ankthin apo shëndetin emocional për të cilët është folur pak ose aspak dhe politikat duhet ti kenë në konsideratë përse i përket studentëve pasi ky aspekt ndikon drejtpërsëdrejti në performancën e tyre mësimore.

Rekomandime për Politikat

1. Funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) do të ndihmonte së tepërmi univeristet në menaxhimin efikas të financave dhe investimeve strategjike që i përgjigjen nevojave. Kjo menaxhim efikas i fondit dhe i investimeve realizohet posaçërisht nga kjo agjenci e konceptuar nga shteti pasi qëllimi i saj është, shpërndarja, planifikimi i fondin për mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë dhe infrastrukturën akademike, mbështetjen me bursa studimi për studentët dhe garantimin e skemës së kredive studentore, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
2. Ndërtimi dhe fuqizimi i Portalit Rinia.al nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe ministrive të linjës (ekonomisë, turizmit, drejtësisë) me informacione periodike dhe të përditësuara mbi legjislacionin e punësimit, tregun e punës, skemat mbështetëse për sipërmarrjet rinore etj, do të ndihmonte studentët për një informacion të plotë (kohë reale) mbi mundësitë e tyre të punësimit. Kjo nevojë kaq e madhe si në situatën e pandemisë ku cdo veprim bëhet në mënyrë digjitale por edhe post-pandemisë do të ishte një ndihmesë e madhe për çdo student.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave merr përsipër të ofrojë në mënyrë të detyrueshme një tipologji dhe një formule unike të planeve dhe programeve mësimore për të gjitha universitetet e Shqipërisë, nuk lejon përshtatjen e programeve mësimore sipas nevojave në auditor. Kjo nuk i lejon univeristet ti përshtatin veprimet e tyre, investimet e tyre me nevojat akute që kanë studentët dhe vetë univeristet. Prandaj në këtë situatë sigurisht do të ishte e domosdoshme si hap fillestar lejimi i strukturave të universiteteve në organizmi, krijimi dhe përshtatjen e programeve mësimore sipas nevojave në auditor pasi janë këto organizma të cilat janë më afër me nevojat e studentëve dhe të auditorit.
4. Miratimi i një akti nënligjor specifik nga komisioni i ligjeve deleguar ministrisë së linjës për të orientuar me pas univeristet për diplomimin dhe realizimin e tij në kushtet e një gjendje si ajo e pandemisë apo një emergjence tjetër natyrore që mund të ndodhë, ose shtojcë në ligjin aktual që parashikon edhe këtë lloj diplomimi si edhe standartet për mënyrën e realizimit të diplomimit në mënyrë elektronike me specifikat e duhura për platformën ku do të prezantohet mënyrën dhe kohëzgjatjen.
5. Ndërhyrje e menjëhershme e pushtetit vendor për çështjet e pagesave të godinave të banimit. Si hap fillestar domosdoshmërisht të ketë koordinim mes Bashkisë Tirnav dhe Drejtorisë së Qytetit Studentit dhe të kryhet kthimi i pagesave me të paktën 50% për studentët të cilët kanë paguar konviktet deri në këtë periudhë ku mësimi është zhvilluar online dhe ato nuk i kanë shfrytëuar ambientet. Nëse edhe muaji i ardhshëm është online të ketë një kthim total të pagesës pasi gati 90% e vitit akademik është zhvilluar online. Gjithashtu mund të ketë amnisti dhe dhënie përparësie shërbimi për këta studentë vitin e ardhshëm akademik.

6. Marrja në konsideratë e sondazheve dhe e sugjerimeve të bëra edhe më parë nga organizatat jo qeveritare të dedikuara për arsimin si nga pushteti vendor ashtu edhe ai qendror si edhe vetë universitetet.
7. Orientim të universiteteve nga MASR për të ardhmen e mësimdhënies dhe kushteve të reja të punësimeve të stafit akademik të cilët duhet të dëshmojnë jo vetëm përgatitjen nga ana shkencore ,por edhe njohuri të përdorimit të platformave të mësimdhënies me format e reja teknologjike të mësimdhënies në fushën përkatëse.
8. Rishikimi i kushteve të përzgjedhjes së studentëve për këshillet studentore apo përfaqësimin në senat duke riparë kriteret.
9. Rishikimi i mundësisë që për cdo department përvec këshillimit të karrierës të ketë edhe një psikolog për shkak të problemeve të shtuara gjatë pandemisë të cilat mund të ndikojnë në shëndetin mendor dhe emocional të studentëve.
10. Dhënie prioriteti ndaj instrumentave që lidhen me konkurrueshmërinë, rritjen e kapacitetit kërkues, rekrutimin e talenteve.
11. Përmirësimi në ofrimin e mësimdhënies për studentët me nevoja të veçanta. Janëkategoria që ndikohen më shumë nga mbyllja e universiteteve. Shumë herë u nevojiten programe më individuale.
12. Ndihmesa nga qeveria/ministria sa i përket uljes së kostos së internetit për personat që kanë pamundësi. Trasmetimet nga kanalet publike janë bërë për arsimin parauniversitar.
13. Mungesa e ambjenteve virtuale të mësimin është një problematikë tjetër. Duhet të ketë laboratore online dhe biblioteka online për materiale për studentët.